



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 9, datë 31.01.2019**

**PËR**

**MIRATIMIN E KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES SË SHOQËRISË AUDITUESE,  
PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË AUTORITETIT TË  
MBIKËQYRJES FINANCIARE, PËR VITIN 2018**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 16, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kriterëve të përzgjedhjes së shoqërisë audituese, për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2018, të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si më poshtë:
  - a. Të jetë i licencuar apo i regjistruar në regjistrin publik si Auditues Ligjor për ushtrimin e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë;
  - b. Të ketë mbi 5 (pesë) vjet eksperiencë në fushën e auditimit ligjor të pasqyrave financiare të bankave ose subjekteve të tjerë financiare dhe autoritete rregullatore financiare që mbajnë kontabilitetin sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-ve);
  - c. Të paktën dy prej ortakëve ose të punësuarve të shoqërisë të kenë titull profesional “Auditues Ligjor”;
  - d. Të mos ketë konflikt interesash me subjektin që auditon, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”;

- e. Të mos jetë subjekt i masave disiplinore në 3 (tre) vitet e fundit dhe në fuqi, të vendosura nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike;
  - f. Të ketë fituar titullin ACCA të paktën njëri nga ortakët.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**